



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr. 27/2008
Më 22.12.2008, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani- kryetare e komisionit, Ethem Çeku, Slobodan Petroviq Haki Shatri, Kaqusha Jashari, Safete Hadergjonaj, Fatmir Rexhepi, Zef Morina, Sala Berisha – Shala;

Mungoj: Berim Ramosaj dhe Mufëra Şinik;

Pjesëmarrës tjerë: Nysret Avdiu dhe Theranda Beqiri (anëtarë të Bordit të ZRRE-së), Muharrem Gashi (ekonomist për çështje rregullative/ZRRE) Ardian Berisha (analist i kostos dhe çmimeve/ZRRE), Blerina Uka nga NDI, Isuf Zejna nga KDI-ja dhe Lumnije Berisha nga Presidenca;

Nga Zyra Mbështetëse: Armend Ademaj dhe Besim Haliti;

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani-.kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 24.12.2008;
3. Shqyrtimi i Vendimit të ZRRE-së, për Tarifatat të energjisë elektrike 3(ShTE3)-Parimet dhe Orari (Nr.418/08 datë 01.12.2008) dhe Përcaktimi i Tarifave nxitëse (feed-in) për prodhimin e energjisë nga hidrocentralet e vogla (Nr.414/08 datë 25.11.2008);
4. Të ndryshme;

I. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 24 dhjetor 2008;

Procesverbali i mbledhjes së datës 24 dhjetor 2008, u miratua pa vërejtje.

III. Shqyrtimi i Vendimeve të ZRRE-së, për Tarifat të energjisë elektrike 3(ShTE3) - Parimet dhe Orari (Nr.418/08 datë 01.12.2008) dhe Përcaktimi i Tarifave nxitëse (feed-in) për prodhimin e energjisë nga hidrocentralet e vogla (Nr.414/08 datë 25.11.2008);

Kryetarja – ia dha fjalën përfaqësuesve të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (në vijim ZRRE-ja), për të dhenë sqarime të mëtutjeshme për vendimet e tyre.

Nysret Avdiu (anëtarë i Bordit të ZRRE-së) – theksoj që definimi që i është bërë tek tarifat është plotësimi i procesit nëse ka aplikacione prej kompanive të licensuara, dhe atëherë duhet të shqyrtohen ato aplikacione, dhe ajo është një procedurë dhe një skenar i përgatitur me data, aktivitete etj. Lidhur me aktivitetet e tarifave ai tha se mund të pyetni znj. Theranda Beqiri, udhëheqëse e Departamentit për Tarifa. Duke e diskutuar çështjen e privatizimit dhe furnizimit, ai tha se është një pikë e ndishme e cila do të implikon edhe çështjen e Kosovës si zgjidhje të re, duke shtuar se sa janë të informuar do të kërkojnë garancion nga shteti për ndërtimin e kapacitetit të ri, do të thotë në qoftë se Qeveria apo Parlamenti hyn në garanca për një furnizues publik, e ndërkohë ne jemi komeptent për licencimin edhe të furnizuesve të rinjë publik, të cilët paraqiten në teritor të Kosovës atëherë del një jo barazi në mes të kompanive edhe ky është një problem serioz i cili duhet të shikohet se si do të zgjidhet apo a do të shkoj si komplet distribucioni në privatizim, apo do të ketë diskutim. Duke u ndalur në përvojat e Shqipërisë, ai tha se është një provojë e cila po mirret nga atje dhe ata e kanë privatizuar furnizimin vetëm me pakicë, por e kanë formuar një me shumicë dhe është bërë një zgjidhje e si do të shkon më tutje do të shohim. Ndërkaq sa i përket ZRRE-së, shtoj se sigurisht që do ti kemi të gjitha rregullat të cilat janë publikuar deri më tani, të cilat do të jenë në fokus të investitorit të ardhshëm, aty është transferi i licencave, obligimet ndaj konsumatorit, kualiteti i energjisë etj.

Theranda Beqiri (anëtare e Bordit të ZRRE-së) – duke përkrahur deklaratën e z.Avdiu, ajo tha se kjo është faza e tretë e tarifave të energjisë elektrike, që do të thotë është viti i tretë, kjo si aplikim i tarifave shkon në bazë të tarifave vjetore në qershor, për shkak se ZRRE-ja, nuk ka pasur kforum në qershor për të marr vendim. Pastaj tek parimet siç është në letrën si proces i hargjimeve të energjisë elektrike të lloraritjes të tarifave në bazë të shpenzimeve që i shkakton ndërmarrja energjetike, gjithashtu vëmendje të veçante i shkaktohet edhe konsumatorit duke marrur parasysh çmimin e indeksit dhe inflamacionit, shtoj znj.Beqiri. Ajo tha se parimet e aplikimit në këtë vit i kemi marrur parasysh aplikimet e vitit 2007 dhe 2008, kështuqë kemi parasysh modelin ekzistues të tarifave që kemi bërë më përpara dhe kemi një lëvizje graduale të cilat reflektojnë kostot për shkaqe të konsiderusheme sa i përket tarifave sepse është një proces i cili na ka reflektuar një problem të përcaktuar me ligj edhe duke përfshirë tarifat relative industriale, komerciale dhe shtëpiake. Në fund të diskutimit tha se tani e tutje

shpresojmë që do të kemi tarifata e reja, kështuqë ne mundohemi që të jemi sa më real dhe të gjitha gjërat me i potencuar.

Ethem Çeku – pyeti se a është hapur çështja e privatizimit të distribucionit që një pjesë ju do të jeni shumë të ngarkuar apo do të jeni dhe kështu që duhet të jeni akterët kyq të çështjes të privatizimit të distribucionit, sepse problemi jonë paraqitet tek roli juaj në këtë proces, e para, nderkaq e dyta është që si mund ta kryejmë privatizimin e mos të kemi rritje të tarifave dhe sa ju do të mund ta përmbani, dhe e treta sa ju do të mund të njoftoni shumë mirë investimet, që ato investime të mos jenë krejt reale nga investitorët e huaj. Dhe në fund kërkoj që të spjegohet se në Maqedoni, a ka shkuar bashkë distribucioni dhe furnizimi në privatizim, apo ka shkuar në njërin e në tjetrën jo, poashtu këtë përgjegje e kërkoj edhe për Shqipërinë.

Nysret Avdiu (anëtarë i Bordit të ZRRE-së) – tha se vetëm distribucioni është privatizuar në këto dy vende. Duke shtuar se në këtë problematik të çështjes së distribucionit duhet pasur mjaft mundësi që të qasemi që të kemi një treg atëhere kualiteti i energjisë elektrike, i cili për ne është një problem shumë i rëndë duke e ditur çfarë gjendje ne kemi në tensionin e ulët në shumicën e teritorit të Kosovës, e ato kërkojnë investime. Pastaj ai shtoi se në fushën e privatizimit duhet parë një plan investiv i cili përfshin një periudhe bukur të gjatë të investimeve për të cilin duhet të bëhet modeli për të cilin shifet se sa duhet bërë investimi të çmimit të cilin e jep distribucioni në këtë rast duke e parë çmimin e investitorit.

V. Të ndryshme;

V. a) Monitorimi i Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët;

Kryetarja – kërkoj nga grupi punues gjegjësisht deputeti Zef Morina, kryesues i këtij grupi, raportim për monitorimin e Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët;

Zef Morina – tha se shpejti do të mblidhet grupi punues e që do t'i raportoi komisionit për këtë çështje. Poashtu propozoj që të vazhdoj puna e grupit punues në një afat dy mujor gjegjësisht nga data 15 janar deri më 15 mars 2008.

Pas diskutimit të gjerë nga deputetet Sala Berisha-Shala, Kaqusha Jashari dhe Safete Hadergjonaj, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- I. Grupi punues të intensifikoj punën për monitorimin e Ligjit Nr.2003/11 për Rrugët, gjatë intervalit kohor 15 janar deri më 15 shkurt 2008;

Mbledhja përfundoi në orën 12:30;

Kryetare e Komisionit;

Myzejene Selmani